



Datë: 04.08.2025
Numër Protokolli: 5222/2025

A.nr.1212/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli-, në cilësinë e procesmbajtëses duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.1212/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesja L.L nga Prishtina, kundër organit të punësimit, në MPJD në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1212/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesja L.L.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile L.L, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), e punësuar në MPJD ka parashtruar ankesën me numër protokolli 4309/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kontestim konkursi të datës 25.03.2025, e njëjta më datë 11.07.2025 ka tërhequr ankesën e datës 24.06.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën A.nr.1212/2025 të datës 24.06.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Konkursi i datës 25.03.2025; Njoftimin e datës 23.04.2025; Njoftimin e datës 07.05.2025; Vendimin e datës 07.05.2025; Njoftimin e datës 26.05.2025; Njoftimi për kandidatin fitues të datës 26.05.2025; Konkursi; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoj procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankueses, **sepse:**

Ankuesja, me datë 11.07.2025 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka përcjellë parashtrësë juridike, përmes së cilës deklarohet se e njëjta është tërhequr nga ankesa e saj e parashtruar përmes emailit kundër kontestimit të konkursit për pozitën Drejtor i Departamentit të

Diasporës, dhe shpalljes së rezultateve për kandidatët fitues, ndërsa parashtesa e të njëjtës e datës 11.07.2025 në Këshill është protokolluar me numër:4669/2025.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë; 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë”* dhe erdhi në përfundimin se ankuesja përmes parashtresës së datës 11.07.2025 me numër protokolli:4669/2025 është tërhequr nga ankesa e saj e datës 24.06.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankueses A.nr.1212/2025 të datës 24.06.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1212/2025

Sabile AVDYLI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses L.L;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.